

INFORMATIKA E BIZNESIT 3+1, Dr.sc. Ramë Likaj, Prof.as

1. Hyrje

- Organizimi i ligjëratave dhe rregullat e përgjithshme
- Motivacioni
- Bazat e sistemeve informative të biznesit

2. ORGANIZIMI I LIGJËRATAVE DHE RREGULLAT E PËRGJITHSHME

- Ligjëratat janë të obligueshme për studentët e rregullt dhe rekomandohen për studentët me korrespondencë,
- Studentët e rregullt munden që të mungojnë tri herë në ligjëratat,
- Prania në ligjëratat bart 10% në forminin e notës përfundimtare,
- Studentët që kanë më tepër se tri mungesa gjatë semestrit humbin 10% të notës që ka të bëjë me pjesëmarrjen,
- Ushtrimet janë të obligueshme për të gjithë studentët: të rregullt dhe me korrespondencë,
- Studentët mund të mungojnë në ushtrime vetëm dy herë gjatë semestrit,
- Të gjithë studentët duhet të realizojnë së paku 8 pikë në secilin ushtrim,

Marrja e nënshkrimit:

- Plotësimi i kushteve minimale për ushtrime,
- Prania,
- Realizimi i të gjitha ushtrimeve dhe prezentimi i tyre,
- Dhënia e dy kolokvimeve,

Formimi i notës:

- Sipas rezultateve të arritura në ushtrime dhe kolokvime,
- Pjesës teorike të provimit,
- Pjesës praktike të provimit.

Pjesa teorike mund të kalohet në njërin nga dy mundësitë:

- Me kalimin e dy kolokvimeve gjatë semestrit,
- Me kalimin e provimit përfundimtar, në afatin e provimeve.

Pjesa praktike mund të kalohet gjatë semestrit me kryerjen e obligimeve në ushtrime.

Poenat	Pjesa teorike	Pjesa Praktike	Pjesëmarrja
	50	40	10

Principi i realizimit të pikëve

PJESA TEORIKE E PROVIMIT		
Mënyra e dhënies	Dy kolokvime	Provimi përfundimtar
Pikët	50	50
PJESA PRAKTIKE E PROVIMIT		
Mënyra e dhënies	Zgjedhja e detyrave të ushtrimeve dhe 2 seminareve	
Pikët	40	
PJESEMARRJA		
Pikët	10	

Tabela për krijimin e pikëve:

Ligjëratat (pjesa teorike e provimit)	
Prania në ligjërata	10 pikë
Kolokviumi i parë	25 pikë
Kolokviumi i dytë	25 pikë
Ushtrimet (pjesa praktike e provimit)	
Detyrat e ushtrimeve***	10 pikë
Seminari i parë**	15 pikë
Seminari i dytë*	15 pikë
Provimi (pjesa teorike)	
Provimi përfundimtar	50 pikë

*** janë të obligueshme që të realizohen

** është e obligueshme të realizohen të paktën 8 pikë

* mund të realizohen pikët e nevojshme përmes kolokviumeve apo pjesëmarrjes në ligjërata dhe ushtrime

Mënyra e llogaritjes së pikëve:

**Totali=Pikët_Ligj_Kol+Pikët_Ligj_Pjesëmarrja+Pikët_Usht_Sem
ose**

Totali=Pikët_Prov-Përf+Pikët_Ligj_Pjesëmarrja+Pikët_Usht_Sem

Vlerësimin përfundimtar i studentit llogaritet sipas mënyrave të përshkruara më sipër, ndërsa nga kufijtë e mëposhtëm të pikëve fitohen notat:

Nota	ECTS nota	Suksesi në %	Përkufizimi
10	A	91-100%	SHKËLQYESHËM – njohuri të shkëlqyeshme me vetëm disa gabime minore
9	B	81-90%	SHUMË MIRË –arritje mbi mesatare, por me disa gabime
8	C	71-80%	MIRË – rezultat në përgjithësi i mirë me disa gabime që vërehen
7	D	61-70%	KËNAQSHËM - mirë, por me mjaftë gabime
6	E	51-60%	MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale
5	FX	40-50%	DOBËT - kërkohet edhe pak punë nga studenti për të fituar kredit
5	F	00-39%	DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredit.

JAVA	TEMA	Numri i orëve
1.	Bazat e sistemit informativ të biznesit	2
2.	Përparësitë e përdorimit të TI	2
3.	Teknologjia informative (Hardveri)	2
4.	Teknologjia informative (Softveri)	2
5.	Teknologjia informative (Baza e të dhënave)	2
6.	Telekomunikimet dhe rrjeti kompjuterik	2
7.	E-biznesi i ndërmarrjes	2
8.	E-biznesi dhe tregëtia	2
9.	Sistemet që mbështesin vendim marrjen	2
10.	Inteligjenca artificiale	2
11.	Manaxhimi i projekteve	2
12.	Manaxhimi i ndryshimeve	2
13.	Siguria e sistemeve informative	2
14.	Problemet etike	2

LITERATURA

a) Bazike:

- 1) Mihane Berisha-Namani: Informatika e Biznesit, Fakulteti Ekonomik, Prishtinë
- 2) Ante Panjkot: Poslovna informatika za ekonomiste, Universiteti i Zarës, 2008, Kroaci.

b) Plotësuese:

- 1) K. Laudon, J. Laudon "Management Information Systems" 2001 Prentice Hall, New Jersey
- 2) Zhelko Panian: Informatika afariste për ekonomistë, Victory, 2006 Prishtinë.

Informatat për kontakt

Dr.sc. Ramë Likaj, Prof.as.
e-mail: ramelikaj@gmail.com

First say to yourself who you would be; /së pari tregoj vetvetes se kush dëshironi të jeni and then do what you have to do./ atëhere bëje atë që duhet.

Epicetetus

MOTIVIMI

- Pse menaxherëve të ardhshëm ju nevoiten njohuritë nga këto ligjëratat?
- Pse kemi nevojë që në punën e përditshme të shfrytëzojmë TI?
- Si ndryshojnë sistemet informative mënyrën e afarizmit dhe strukturën organizative?
- Investimet në TI, shpaguhen shumëfish.

Pse menaxherëve të ardhshëm ju nevoiten njohuritë nga këto ligjëratat?

- Sistemet informative (SI) dhe TI janë pjesë e suksesit afarist,
- SI dhe TI paraqesin fushë të rëndësishme me rastin e administrimit dhe udhëheqjes së afarizmit dhe organizimit,
- Ligjëratat nga Informatika e biznesit janë pjesë e grupit të ligjëratave obligative ose zgjedhore në shumicën e universiteteve/fakulteteve të biznesit në tërë botën,
- Në shumicën e rasteve mund të gjenden këto ligjëratat me emërtime të ngjashme:
 - Sistemet informative të biznesit,
 - Sistemet informative të menaxhmentit,
 - Përdorimi i TI në biznes.

Pse kemi nevojë që në punën e përditshme të shfrytëzojmë TI?

- SI dhe TI, i ndihmojnë biznesit që të zhvillohet dhe të mbetet konkurent,
- Biznesi dhe organizimi e shfrytëzojnë TI dhe SI për:
 - Për përmirësimin e veprimtarisë biznesore dhe në përgjithësi për efikasitet më të lartë të të gjitha proceseve,
 - Si mjet për marrjen e vendimeve menaxheriale më të shpejta dhe me risk më të vogël,
 - Për përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkëpunëtorëve.
- Organizata e juaj duhet që pa ndërprerë të zhvillohet në mënyrë që të mbetet konkurrese dhe në përgjithësi të mund të mbijetoj,
 - Një prej segmenteve më të rëndësishme se si të mund të realizohet kjo gjë është përdorimi i TI.
- 50% e investimeve të organizatave dhe ndërmarrjeve të suksesshme ndërkombëtare janë investime në sektorin e TI.
 - A mendoni se këto janë të rastësishme?
 - A mendoni se këto janë vetëm trende mërie të menaxherëve?

Si ndryshojnë sistemet informative mënyrën e afarizmit dhe strukturën organizative?

- Informacionet nuk janë të përshtatshme vetëm për kuadrot menaxhuese por pothuasje për të gjitha pjesët e kolektivit,

- Nevoja për ndryshimin e organizimit → tash bazohet në qarkullimin e informatave, dhe jo në nevojën për respektimin e hierarkisë,
- Krijojnë platformën për raporte bashkëpunimi mbrenda organizatës,
- Mundësojnë krijimin e prodhimeve dhe shërbimeve “inteligjente”, të cilat i janë përshtatur nevojave reale të konsumatorëve → parakusht për kalimin në ekonominë e orientuar informative dhe largimin nga ekonomia e prodhimit dhe konsumit masiv,
- Marrjen e informatave të nevojshme në kohën reale dhe informatave,
- Realizimin më të thjeshtë të të gjitha llojeve të transaksioneve.

Investimet në TI, shpaguhen shumëfish.

- Me investimet në teknologjinë VOIP (Voice Over IP) dhe IVR (Intelligent Voice Recognition) për përcjelljen e thirrjeve telefonike të shfrytëzuesve, të ardhurat e aviokompanisë **Continental Airlines** janë rritur në mënyrë të pabesueshme në vitin 2003, rreth 60% nga viti paraprak,
- Cisco Systems me investimet e bëra në e- business i ka zvogëluar shpenzimet vjetore për 400 mil. \$
- Me krijimin e sistemeve e – learning, HP i ka zvogëluar shpenzimet vjetore për trajnimin e serviserëve në tërë botën për 500 mil. \$ në vit,
- Publikimet e shtëpive botuese siq janë: McGraw – Hill dhe John Willey and Sons, me biznesin përmes internetit kanë rritur të ardhurat e tyre në mënyrë të dukshme.

1. BAZAT E SISTEMIT INFORMATIV TË BIZNESIT

REZULTATET E PRITSHME PËR STUDENTËT

- Të kuptojnë nocionin sistem dhe sistem informativ (SI),
- Të kuptojnë se pse njohuritë mbi SI janë të rëndësishme për profesionistët e ardhshëm të biznesit, pra që të identifikojnë pesë fushat e njohurive mbi SI të cilat janë të nevojshme për ta,
- Të kuptojnë me anë të ilustrimeve se në çfarë forme mund të mbështesin SI:
 - proceset biznesore,
 - vendimet menaxheriale,
 - strategjive për të realizuar përparësi në konkurrencë,
- Të mund të dallojnë disa lloje të SI kryesore të organizatave biznesore nga jeta e përditshme,
- Për të siguruar shembuj të komponenteve të vërteta të SI,
- Të konfirmojnë normat etike me të cilat menaxherët mund të përballen me rastin e përdorimit të TI në biznes,
- Për të treguar që shfrytëzuesit e TI, përdorin hardverin, softverin, rrjetet e të dhënave dhe komunikuese si resurse me anë të cilave përmes aktiviteteve të drejtimit, resurset e të dhënave transformohen në informata të rëndësishme, të cilat e furnizojnë me rregull me të gjitha madhësitë hyrëse dhe dalëse të SI, si dhe rezultatet e shumë aktiviteteve mbrenda vetë sistemit,
- Të fitojnë njohuri për mundësitë e shumta të punësimit në fushën e SI.

1.1 SISTEMI

- Qka është sistemi?
 - Sistemi është bashkësi e komponenteve të lidhura ndërmjet veti,
 - Me kufinj të definuar në mënyrë të saktë,

- Të cilat veprojnë së bashku për të realizuar qëllimin e caktuar, apo plotësimin e kërkesave të caktuara,
- Pranimin e madhësive hyrëse dhe prodhimin e rezultateve përmes një procesi të organizuar të transformimit, duke këmbyer ndërmjet vete materie, energji dhe informata.

Sistemi është bashkësi e strukturuar e elementeve të ndërlidhura të cilat ndërveprojnë në njëra tjetrën dhe me rrethinën e tyre, me qëllim të plotësimin të kërkesave apo funksioneve të caktuara.



$$\text{DALJA} = T (\text{HYRJES})$$

Secili sistem e bën transformimin e hyrjes, përmes procesit përkatës, duke dhënë daljen e caktuar → që zakonisht duhet të jetë dalje e dëshiruar, por nuk është gjithmonë kështu.

Pra, secili sistem karakterizohet me:

- **Input** (hyrja), që përmban madhësi të veqanta ose të përbashkëta, të cilat hyjnë në sistem për tu procesuar,
- **Processing** (përpunimi) paraqet proceset e transformimit të cilat e shndërrojnë hyrjen në dalje,
- **Output** (dalja) janë madhësitë e transformuara, si produkt i procesit të transformimit mbrenda sistemit - me orientim në destinimin e tyre përfundimtar.

Pra:

- Me sistem mund të nënkuptojmë çdo gjë.
- Është e qartë se sistemi mund të jetë pjesë e një sistemi tjetër ose nënsistem i një sistemi tjetër.
- Secili sistem përbëhet nga një numër më i madh i nënsistemeve.
- Sistemi shpesh ka disa veçori që nuk i kanë asnjë prej nënsistemeve të tijë.

Secili sistem ka:

- Elementet (E),
- Strukturën (R),
- Qëllimin që shpesh e quajmë funksionin (F).

Për të definuar diçka si sisteme, duhet të përcaktojmë:

- Komponentet e sistemit,
- Kufijtë e sistemit,
- Strukturën e sistemit,
- Rrethinën e sistemit,
- Lidhjet në sistem,
- Funkcionin e sistemit,
- Proceset në sistem,
- Ligjshmëritë të cilat e mbizotërojnë sistemin.

Komponentet e sistemit

Pjesët e sistemit mund të jenë:

- Elementet – nuk mund të thjeshtohen më tutje në njësi strukturore më të vogla,
- Nën sisteme – mund të ndahen më tutje.

Kufijtë – e përkufizojnë/rrethojnë sistemin:

- Gjithë çka jashtë kufinjëve është **rrethina e sistemit**,
- Kufijtë e sistemit mund të ndryshojnë,
- Si mund të përcaktohen → me shtrimin e dy pyetjeve:
 1. A është objekti i shqyrtuar ose dukuria nën **kontrollën e sistemit**?
 2. Objekti i shqyrtuar apo dukuria, a mund të përcaktojë **funksionimin e sistemit**?

Struktura e sistemit - është e përcaktuar sipas mënyrës se si komponentet e sistemit krijojnë lidhje ndërmjet vete:

- Lidhjet informative,
- Lidhjet materiale,
- Lidhjet energjetike.

Sistemi krijon lidhje edhe me rrethinën (lidhjet e njëjta).

- Hyrjet,
- Daljet.

1.2. SISTEMI DHE ENTROPIA

Proceset paraqesin mënyrën e ndryshimit të **gjendjes** të komponenteve të veçanta dhe të tërë sistemit.

- Me rrjedhën e procesit sistemi përmbush funksionet e tij dhe realizon qëllimet.


Me veprimin e duhur në variablat e sistemit, ai kalon në gjendjen e dëshiruar → rregullim i sistemit,

Çka është ENTROPIA:

Çdo sistem të cilin nuk mund të parashikojmë sjelljen në të ardhshmen, i cili e humb vlerën dhe mundësinë në funksion të realizimit të objektivave → themi se rriten çrregullimet e sistemit, kjo dukuri njihet si **entropi e sistemit**.

ENTROPIA = ÇRREGULLIM

Shkalla e entropisë varet nga probabiliteti i shpërndarjes së gjendjeve të mundshme të sistemit.




ENTROPIA vs INFORMACIONET

- Entropia ka natyrën e njëjtë sikurse edhe informacionet, por me parashenjë të kundërt i informacionit,
- Shihet që informacionet mund ta shkatërrojnë entropinë në procesin e rregullimit.


1.3. SISTEMET KIBERNETIKE

- Të gjitha sistemet karakterizohen me hyrjen, përpunimin dhe daljen,
- Sistemi kibernetik (**cybernetic system**) → sistemet vetrregulluese → kanë lidhjen kthyesë dhe njësinë për rregullim:
 - **Feedback (lidhja kthyesë)** jep të dhënat kthyesë mbi punën e sistemit,
 - **Control (rregullimi)** përmban nadzor dhe vlerësimin e lidhjes kthyesë për tu siguruar se sistemi a është duke lëvizur sipas caktit të dëshiruar.
- Kibernetika (gr. E vjetër Kybernao – drejtoj, drejtoj anijen) → nocion i përdorur më 1948. nga Norbert Wiener, Austri.
- Sistemet informative si një këndvështrim i sistemeve kibernetike.




Sistemi kibernetik


1.4. SISTEMI I BIZNESIT



1.5. SISTEMI INFORMATIV DHE AKTIVITETET



1.6. QARKULLIMI DHE GRANULARITETI I INFORMATAVE NË ORGANIZATË




1.7. SISTEMI INFORMATIV

Çka është sistemi informativ:

- Kombinim i organizuar i:
 - Njeriut,
 - Hardverit,
 - Softverit,
 - Rrjeteve komunikuese,
 - Resurseve të dhënave,
 - Mënyrës së punës dhe procedurave.
- I cili furnizon, merr, transformon dhe shpërndan informatat mbrenda organizatës, dhe sipas nevojës edhe i këmben ato me rrethinën.

Detyra e sistemit informativ është që:

- Tu përshkruajë në mënyrë të drejtë dhe saktë informatat atyre që kanë nevojë për to, në kohën e duhur, në vëllimin/sasinë e nevojshëm dhe në formatin më të përshtatshëm,
- Mund të themi që sistemi informativ (SI), kryen këto detyra:
 - Mbledhë të dhënat,
 - Përpunon të dhënat,
 - Furnizon me të dhëna dhe informata,
 - Shpërndan të dhënat dhe informatat shfrytëzuesve,
 - SI bashkëkohore – kryen edhe funksionet vijuese të ashtëquajtura “Data mining- eskavim/gjurim i të dhënave”, çka nënkupton kërkimin e lidhjeve ndërmjet të dhënave dhe informatave pasuese të cilat nuk janë të dukshme në mënyrë direkte, dhe në bazë të kësaj gjenerimin e informatave të reja – njohurive të reja.



Nga figura e mësipërme mund të vërehen komponentet të cilat e karakterizojnë çdo sistem informativ (SI):

1. **Hardware** – pajisjet;
 - a) të gjitha komponentet fizike të cilat shfrytëzohen për përpunimin e informatave,
 - b) makinat, mediumet e të dhënave, pajisjet periferike,
2. **Software** – zgjedhjet programore;
 - a) softverët sistemor,
 - b) softverët aplikativ dhe procedurat.
3. **Lifeware** – potenciali njerëzor i cili punon me SI – qoftë si informatikantë apo shfrytëzues të zakonshëm
 - Shfrytëzuesit e fundëm (End users): njerëzit të cilët e shfrytëzojnë SI apo informatat nga SI,
 - Profesionistët e SI (IS specialists): njerëzit të cilët e zhvillojnë dhe e mbirëmbajnë SI.
4. **Orgware** – modeli organizative, i cili i ndërlidh tri komponentet paraprake në një tërësi të pajtueshme dhe funksionale,
5. **Netware** – kanalet komunikuese të ndërlidhjes së të gjitha elementeve të sistemit në një tërësi;
 - Interneti, intraneti dhe ekstraneti,
 - Rrjetet telekomunikuese.

Këtyre komponenteve të SI mund ti bashkangjesim edhe:


- **Resurset e të dhënave (Data Resources),**
 - Njohuritë mbi transaksionet afariste,
 - Përpunimin dhe organizimin e të dhënave,
 - Bazën e të dhënave.
- **Të dhënat (Data)** janë shënime të papërpunuara mbi dukuritë fizike ose transaksionet afariste,

- **Informata (Information)** janë të dhënat e përpunuara të shndërruara që ka përmbajtje të kuptueshme dhe të shfrytëzueshme për shfrytëzuesin,

Shembull:

- Të dhënat për shitjen janë emërtimet e artikujve, sasia dhe çmimet,
- Informatat e shitjes janë sasia e shitjes sipas artikujve, vendi i shitjes.

Inputet dhe outputet e SI



INPUTET: aktivitetet e lidhura me pranimin/mbledhjen e të dhënave,

PËRPUNIMI i të **dhënave** në **informata**; llogaritja, rregullimi, sortimi, klasifikimi, ...

OUTPUTET: dalja e produktit informativ; porositë, lajmërimet, formularët, grafiqet,

FURNIZIMI I RESURSEVE ME TË DHËNA: baza e të dhënave dhe deponimi i të dhënave,
RREGULLIMI I SISTEMIT: lidhja rivepruese për vlerësim.

1.8. MUNDËSITË QË OFRON PËRDORIMI I SI

- SI përdoren në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë njerëzore—duke filluar le të themi nga sinjalizuesit e tymit e deri te kartotekat dhe katalogjet e librave në biblioteka,
- Nuk ka kuptim nocioni SI pa përdorimin e kompjuterëve,
- SI të përkrahura me përdorimin e kompjuterëve (computer based information systems – CBIS)—gjendja aktuale,
- **TI paraqet infrastrukturën e SI,**

Në tabelën vijuese janë dhënë mundësitë që na ofrojnë SI

TABELA	MUNDËSITË QË NA OFROJNË SI
	Kryerja e llogaritjeve matematikore të mëdha për një kohë relativisht të shkurtër
	Sigurimi i një komunikimi të shpejtë dhe të saktë, e me këtë edhe bashkëpunimin mbrenda dhe ndërmjet kompanive
	Furnizon me sasi të madhe të dhënave dhe informatave me anë të cilave punohet shpejt dhe duke zënë një hapësirë të vogël
	Sigurojnë mbledhje/shpërndarje të shpejtë nga vende të ndryshme
	Realizojnë interpretimin e një sasive shumë të madhe të informatave
	Rritje të efektivitetit dhe efikasitetit të punës të shumë njerëzve në grupe punuese nga një apo më shumë vende pune
	Automatizimin e shumicës së proceseve

1.9. SISTEMET INFORMATIVE (SI) DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE (TI)

- **SI** paraqet bashkësinë e komponenteve dhe resurseve të domosdoshme për përshkrimin e funksioneve në ndonjë organizatë,
- **TI** paraqet hardeverin, softverin, të gjitha llojet e rrjeteve dhe udhëheqjen/dirigjimin me të dhënat,
- **TI** i mundëson **SI** që ta realizoj funksionin e sajë,
- Teoritikisht, SI mund të jetë i mbështetur në punën me shumë dokumenta të letrës → ashtu siç ka qenë në të kaluarën jo të largët,
- Ashtu siç kemi thënë edhe më heret ne do të trajtojmë në këtë kurs me SI të mbështetura nga TI (Computer-Based Information Systems - CBIS)

LLOJET E SISTEMEVE INFORMATIVE

- **Computer Hardware Technologies**, përfshijnë lloje të ndryshme të kompjuterëve me përmasa të ndryshme, sisteme mainframe, paisje hyrëse dhe dalëse, paisje për krijim të dhënave të cilat i mbështesin,
- **Computer Software Technologies**, përfshijnë sisteme operative, web faqet, programet për komunikim dhe bashkëpunim afarist, aplikacione për biznes, aplikacione për udhëheqje të proceseve prodhuese etj.
- **Telecommunications Network Technologies**, përfshijnë mediat telekomunikuese, hardverët dhe softverët e nevojshëm për sigurimin e çasjes me dhe pa tela, si dhe për përkrahje të çasjes në internet, rrjetet private etj,
- **Data Resource Management Technologies**, përfshijnë softverët sistemor për udhëheqjen e bazës së të dhënave për zhvillim, qasje dhe mirëmbajtjen e të dhënave të organizatës.

TI- FAKTOR KYÇ PËR MBËSHTETJEN E BIZNESIT

- **Realizimi i pëparësisë konkurruese** – rritjen e vlerës së prodhimit apo shërbimit për shfrytëzuesin/blerësin përfundimtar krahasuar me atë të konkurentit,
- **Shfrytëzoheni teknologjinë për:**
 - Arritjen e përsosshmërisë operative,
 - Iniciativave kryesore afariste,
 - Përmirësimin e procesit të marrjes së vendimeve,
 - Transformimin e organizatës/re-inxhinieringu i biznesit

STRUKTURA E NJOHURIVE PËR SI




Struktura e rekomanduar e njohurive të SI, për profesionista të biznesit (sipas James A. O'Brien)

ÇKA DUHET TË DIJË SECILI PROFESIONIST NË BIZNES PËR SI

- **Kuptimet bazike:** kuptimet e sjelljes/reagimit, kuptimet teknike, afariste dhe menaxheriale,
- **Bazat e teknologjisë informative (TI):** Hardware, software, rrjetat, udhëheqja me të dhënat dhe teknologjia e bazuar në internet,
- **Mundësitë e aplikacioneve afariste:** kryesisht mënyrën e shfrytëzimit të SI mbrenda organizatës,
- **Rëndësinë e sigurisë së SI:** sigurinë e të dhënave në të gjitha nivelet, bazat ligjore,
- **Si të udhëhiqen projektet dhe zhvillimi/qasja e TI:** si të planifikohet, zhvillohet dhe implementohet SI dhe ajo që ka të bëjë me TI, vlerësimi i kualitetit të tyre, me qëllim të përmbushet strategjia afariste,
- **Cilat janë kërkesat e udhëheqjes:** cila është mënyra më efektive dhe më etike për shfrytëzimin e TI,

ÇKA I OFRON SI BIZNESIT



RRITJA E RËNDËSISË SË PËRDORIMIT TË SI PËRGJATË VITEVE



ÇKA ËSHTË E – BIZNESI

- Përdorimi i Teknologjisë së Internetit për:
 - Për realizimin dhe fuqizimin e procesve afariste, tregëtinë dhe bashkëpunimin elektronik ndërmjet organizatave,
 - Bashkëpunimin mbrenda organizatës dhe puna me shfrytëzuesit e shërbimeve.
- Ndryshimi on-line i vlerës.


KËRKESAT e E – BIZNESIT

- Re-inxhinieringu i proceseve të mbrendshme biznesore,
- **Sistemet e bashkëpunimit të ndërmarrjes (Enterprise collaboration systems):** mirëmbajtja e komunikimit, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërmjet ekipeve dhe grupeve punuese, p.sh. ekipeve virtuale,
- **Tregëtia elektronike (Electronic commerce):** blerja, shitja, marketingu dhe ofrimi i shërbimeve dhe prodhimeve me ndihmën e rrjeteve kompjuterike,



Peter Steiner

Infrastruktura e TI për E-BIZNESIN



LLOJET E SI

I. SISTEMET PËR MBËSHTETJE TË OPERACIONEVE

- Çka bëjnë?
 - Me sukses bëjnë përpunimin e transaksioneve afariste,
 - Udhëheqin proceset industriale,
 - Përkrahin komunikimin dhe bashkëpunimin,
 - Azhurojnë bazën e të dhënave të organizatës

LLOJET E SISTEMEVE QË MBËSHTESIN OPERACIONET

- **Sistemet që mbështesin transkacionet (Transaction Processing Systems):**
 - Regjistrojnë dhe i përpunojnë transkacionet e biznesit,
 - P.sh.: përpunimi i shitjes, sistemet për inventarizim, sistemet llogaritare,
- **Sistemet për udhëheqje të proceseve (Process Control Systems):**
 - Përcjellja dhe udhëheqja me procese fizike,
 - P.sh.: në rafinerinë e naftës sensorët shfrytëzohen për përcjelljen e proceseve kimike.
- **Sistemet për bashkëpunim të ndërmarrjes (Enterprise Collaboration Systems):**
 - Përmirësimin e komunikacionit dhe komunikimit ekipor mbrenda grupeve punuese,
 - P.sh.: e-maili, videokonferencat etj.

DY MËNYRAT E PËRPUNIMIT TË TRANSAKCIONEVE

- **Përpunimi grupor (Batch Processing):**
 - Akumulon transkacionet për një kohë të caktuar dhe bën përpunimin periodik të tyre,
 - P.sh.: banka përpunon çeqet në grup të pranuar deri në orën 20:00,
- **Përpunimi online – në kohë reale (Online Processing):**
 - Bën përpunimin e menjëhershëm të transaksioneve,
 - P.sh.: banka përpunon menjëherë transkacionet në bankomat.

II. SISTEMET PËR MBËSHTETJE TË MENAXHMENTIT- MSS (management support systems)

- Çka bëjnë?
 - Sigurojnë infomatat dhe përkrahin marrjen e suksesshme menaxheriale.

LLOJET E SISTEMEVE MSS

- **Management Information Systems (MIS):**
 - U ofrojnë lajme dhe aspekte të ndryshme vështrimi menaxherëve,
 - P.sh.: lajme për analizën e shitjes ditore,
- **Decision Support Systems (DSS):**
 - Ofrojnë mbështetje interaktive me rastin e sjelljes së vendimeve (raste speciale),
 - P.sh.: çka –nëse analiza (what-if-analysis) për të përcaktuar ze ku të shpenzohen mjetet për shpallje,
- **Executive Information Systems (EIS):**
 - Ofrojnë informata paragjyquese për ekzekutiv dhe menaxherë,
 - Sigurojnë çasje të shpejtë kohore dhe informata strukturore në trajtë të lajmit,
 - P.sh. gjendja mbi prodhueshmërinë e ndonjë prodhimi.

III. SISTEMET SPECIALE MBËSHTETËSE


Sistemet speciale mbështesin:

- Operacionet afariste,
- Marrjen e vendimeve menaxheriale.
- **Sistemet (Expert Systems):**
 - Ofrojnë këshilla eksperte,
 - P.sh. aplikimin e këshilltarit kreditor, aplikimi i këshillave për vërtetimin e prishjeve në automjet,
- **Sistemi për udhëheqje me njohuri (Knowledge Management Systems):**
 - Mbështet krijimin, organizimin dhe shpërndarjen e njohurive afariste nëpër organizatë,
 - P.sh.: qasja në intranet me operatorët më të mirë afarist.

IV. NDARJA E SISTEMEVE SIPAS QËLLIMIT

- **Sistemet afariste funksionale (Functional business systems):**
 - Të drejtuara në operacione dhe aplikacione menaxheriale për funksionet biznesore bazike,
 - P.sh. përkrahje kontabilitetit, financave dhe marketingut.
- **Sistemet strategjike informative (Strategic information systems):**
 - Përkrahje në përfitimin e përparësisë në aspektin e konkurrencës më të madhe,
 - P.sh. përcjellja e dërgesave, e-tregëtia, web sistemet,
- **Sistemet informative ndër-funksionale (Cross-functional information systems):**
 - Sistemet të cilat janë kombinime të disa llojeve të SI,
 - Sigurojnë mbështetjen e një numri më të madh të funksioneve.

KËRKESAT DHE RASTET E TI




MASAT E SUKSESIT TË SI

- **Veprimtaria,**
 - Minimizimi i shpenzimeve,
 - Minimizimi i kohës,
 - Minimizimi i nevojave për resurse informative,
- **Prodhimësia,**
 - Si ti mbështesim strategjitë afariste,
 - Në cilën mënyrë fuqizohen proceset afariste,

- Në cilën masë përmirësohet struktura organizative dhe kualitetin,
- A rriten të ardhurat e shfrytëzuesve të vlerave të afarizmit.


FAZE E UDHËHEQJES ME PROJEKTE



KONCEPTI CHANGE MANAGEMENTA



KËRKESAT ETIKE TË PËRDORIMIT TË TI



ETIKA DHE SIGURIA

- Etika duhet të jetë në rendin e parë,
- Ashtu edhe siguria dhe privatësia.

PËRGJEGJËSIA ETIKE

- **Cila mënyrë e përdorimit të TI konsiderohet e pa pranueshme, dhe si ky përdorim i shkakton dëm individit dhe shoqërisë,**
 - Mbledhja e informatave të cilat nuk duhet ti mbledhim ose mos dhënja e llogarisë për sigurinë dhe privatësisë e shfrytëzuesit/konsumatorit,
- Cila është mënyra e rregullt e përdorimit të internetit dhe resurseve të oragnizuara të TI?
 - P.sh. hulumtimi i web faqeve jo të rrezikshme, dërgimit të e-mailave jo të ndaluar, mbledhja legale e të dhënave dhe informatave nga web faqet- për qështje biznesi etj,
- **Si mund të mbrohemi nga kriminaliteti kompjuterik?**
 - Me përdorimin e antivirusve, antispyware, veglave anti spam, anjëhere të mos i përgjigjemi phishingut etj.

TRENDET E PUNËSIMIT TI

- Shpenzimet e zhvillimit të aplikacioneve dhe të gjitha SI afariste viteve të fundit kanë sjellur deri te përzierja e qendrave të zhvillimit të zgjidhjeve programore në Indi, Kinë, Iran, Kore etj,
- Sa më shumë që kompanitë e zhvillojnë zgjerimin e përdorimit të TI, edhe më shumë punë të reja dhe tërheqëse lindin çdo ditë,
- Gjithmonë ka mungesë për ekspertë të kualifikuar për SI,
- Përparimii vazhdueshëm në fushën e TI, kërkon ndryshimin e vazhdueshëm të kompetencave të vendit të punës, pra kërkon kompetenca të reja, kjo për të punësuarit nënkupton perspektivë të mirë dhe vend tërheqës pune.

RASTET PËR KARRIERË NË FUSHËN E SI

Systems Analyst	System Consultant	Business Applications Consultant
Chief Information Officer	Computer Operator	Computer Serviceperson
Network Administrator	Data Dictionary Specialist	Network Manager
Database Administrator	Database Analyst	Documentation Specialist
IS Auditor	End-User Computer Manager	Equipment Manufacturer Representative
PC Sales Representative	Programmer	Program Librarian
Project Manager	Records Manager	Hardware Sales Representative
Scheduling and Control Person	Security Officer	Office Automation Specialist
Senior Project Leader	Service Sales Representative	Software Sales Representative
Technical Analyst	Software Quality Evaluator	Technical Writer
Telecommunications Specialist	Training & Standards Manager	User Interface Specialist

E ARDHMJA E AFËRT**Profesionet më me prespektivë deri më 2012, në shumicën e vendeve të botës do të jenë:**

- Analist të sistemit,
- Ekspert për siguri në fushën e SI,
- Administrator të bazës së të dhënave,
- Ekspertë të ndryshëm në fushën e inteligjencës artificiale,
- Pozicione të ndryshme menaxheriale,
- Ekspertë rrjetit.

PËRMBLEDHJE**SI paraqesin:**

- Fushën kryesore funksionale të afarizmit,
- Kontribut të rëndësishëm të veprimtarisë dhe efikasitetit, prodhimtarisë së të punësuarve, përmirësimin e shërbimeve dhe kënaqësi më të mëdha shfrytëzuesve të SI,
- Burimin kryesor të informatave dhe mbështetje për sjelljen e vendimeve efektive,
- Përkushtim dhe detyrim për zhvillimin e prodhimeve dhe shërbimeve konkurente në ekonominë globale,
- SI ofrojnë raste dinamike dhe të njohura për karrierë të individëve,
- Nuk mund të paramendohet afarizmi i sotshëm pa SI.